



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Government
Ministria e Ekonomisë/Ministry of Economy

Koncept Dokumenti për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë

Besiana Qorraaj Berisha
27 Korrik ,2021



PËRMBAJTJA

- **Informacione të përgjithshme**
- **Përkufizimi i problemit**
- **Objektivat**
- **Opsionet**
- **Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm**



Informacione të përgjithshme

Koncept dokument për burimet e ripërtëritshme të energjisë

Ministria e Ekonomisë; Departamenti i Energjisë; Divizioni i Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë, Efiçencës dhe Bashkëprodhimit.

- **Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021 -2025**
- 2.14. Energjia dhe Minierat.
- 2.14.1. Krijimi i kushteve për furnizim të qëndrueshëm me energji - Hartimi I Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë dhe rishikimi I legjislacionit në harmoni të plotë me Strategjinë e re për Energji.
- **Prioriteti strategjikë**- Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026
Objektivi 5, pika 2. Programi Kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizimit Asocimit (PKZMSA), Kapitulli 15 i *Acquis*, pika 3.15.9 - miratimi i Koncept Dokumentit për BRE. Agjenda për Reformën Evropiane (ERA 2) Prioriteti 2 Konkurrueshmëria, klima e investimeve dhe zhvillimi i qëndrueshëm; Masa 2.2 Arritja e caqeve për EE dhe BRE, aktiviteti b1.4.



Përkufizimi i problemit

Efekte

1. Mungesa e ambientit të përshtatshëm për krijimin e skemave më fleksibile dhe konkurruese për treg, duke ndikuar në përzgjedhjen e çmimeve më të favorshme për mbështetje;
2. Pamundësia që vendimmarrësit përgjegjës të kufizojnë mbështetjen financiare në atë që është e nevojshme për të siguruar konkurrencën e gjenerimit të BRE-ve në treg;
3. Pamundësia e identifikimit të akterëve dhe ndarjes së përgjegjësive të institucioneve të involvuar në procesin e zhvillimit të projekteve të burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Problem i kryesor

Mangësitë ligjore për trajtimin e sektorit të BRE-ve dhe mospërputhja me kërkesat që rrjedhin nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe aktet tjera të BE-së

Shkaqet

1. Kërkesat nga udhëzuesi i politikave mbi reformat konkurruese të skemës mbështetëse për BRE-të i vitit 2015 i hartuar nga Sekretariati i Komunitetit për Energji, si dhe konkluzionet e Këshillit të Ministrave të vendeve anëtare të Komunitetit të Energjisë.
2. Skemat aktuale të mbështetjes së energjisë nga burimet e ripërtëritshme të energjisë nuk janë në përputhje me dispozitat e ligjit për ndihmën shtetërore.
3. Mungesa e kompetencave dhe bazës ligjore të autoriteteve publike për të vepruar ose marrë vendime që prekin të drejtat themelore.
4. Kërkesat e reja të TKE për përcaktimin e caqeve të reja për periudhën e ardhshme 2021-2030.



Objektivat

Objektivat që synohet të arrihen janë:

- Përmirësimi i infrastrukturës ligjore me qëllim të rritjes të promovimit të sigurisë së furnizimit me energji, promovimin e zhvillimit teknologjik dhe inovacionit, si dhe ofrimi i mundësive për punësim dhe zhvillim rajonal, veçanërisht në zonat rurale.
- Krijimi i një kornizë së përbashkët për promovimin e energjisë nga burimet e ripërtërishme, rritjen e gjenerimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme dhe bashkëprodhimi.
- Përcaktimi dhe organizimi i formës së ofertimit dhe operimit me procedura të veçanta dhe të avancuara sipas direktivave, rregullave dhe obligimeve nga Komuniteti i Energjisë.
- Po ashtu me kërkesat e reja të direktivës përkatëse për burime të ripërtërishme duhet identifikuar masat për plotësimin e caeve të energjisë nga burimet e ripërtërishme duke e përshtatur për këtë Koncept Dokument, dhe normative në të ardhmen pasi miratimit të aktit filan siç parashihet me opsionin e grupit punues.



Opsionet

Opsioni i parë:

Asnjë ndryshim, gjendja aktuale eshte e pamjaftueshme për rregullimin dhe zhvillimin e sektorit të BRE-ve në përputhje me kërkesat e reja të SKE-ë.

Opsioni i dytë:

Rekomandon përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit -Rishikimi i rregullës për Skemën Mbështetëse:

Me përcaktimin e targeteve të reja për pjesëmarrjen e BRE-ve në bruto konsumin final të energjisë për periudhën 2021-2030, nevojitet edhe plotësim ndryshimi i rregullës mbështetëse për BRE, duke u bazuar ne kushtet e konkurrencës dhe kriteret transparent dhe jo diskriminuese për pranim në skemën mbështetëse. Me fjalë të tjera, ndryshimi i rregullave për të vendosur një dallim të qartë midis mekanizmit aktual të skemës së mbështetjes dhe procesit të ankandit do të qartësonte sfidat që investitorët aktualë mund të kenë.



Opsionet

Opsioni i tretë:

Hartimi i projektligjit për burimet e ripërtëritshme të energjisë.

Sipas këtij opsioni, duhet të bëhet hartimi i ligjit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë. Përmes këtij ligji do të eliminohen të gjitha pengesat aktuale dhe do të hapet rruga e zhvillimit të mëtejme të BRE-ve në drejtim të sigurisë së furnizimit me energji dhe zhvillimit ekonomik.

Përmes ligjit të BRE-ve, e gjithë materia në lidhje me BRE-të do të trajtohet në një dokument të vetëm. Do të rregullohen mirë dhe qartë përgjegjësit e institucioneve brenda vendit që lidhen me sektorin e BRE-ve. Krijimi i kushteve për reforma të tregut të energjisë nga BRE-të me fokus rritjen e konkurrencës do jenë mirë të definuara. Mbështetja e prodhimit të energjisë nga BRE-të përmes procedurave konkurruese tenderëve/ankandeve, do jetë një nga elementet që pritet të rregullohet. Me këtë ligj do krijohet ambient me i përshtatshëm për investime, sidomos tërheqjen e investimeve direkt nga jashtë dhe nga diaspora jonë. Sfidat që po e presin Kosovën në raport me zotimet e marra në kuadër të TKE-së në lidhje me zhvillimin e BRE-ve do jenë në fokus të këtij ligji, përfshirë transpozimin e Direktivës së Re për BRE dhe përcaktimin e caqeve për periudhën 2021-2030.



Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm

Drafti i punes eshte plotesuar dhe ndryshuar me mbeshtetjen e USAID-Tetrattech

- Do te procedohet me tutje sipas Udhezuesit per hartimin e Koncept Dokumenteve
- Sipas Planit Operacional te Qeverise pritet te dergohet per miratim ne Qeveri ne periudhen K3
- Ministira ka pranuar poshtu edhe nje mbeshtej nga EBRD per hartimin dhe dizanimimin e ankandeve per BRE.
- Ky proces do te jete paralel edhe me rishikimin e Strategjise se Energjise dhe hartimin e PKEK 2021-2030



JU FALEMINDERTI PËR VËMENDJEN TUAJ